

Bizneset e Huaja në Shqipëri

2014-2016

Tiranë, më 15 dhjetor 2017: Instituti i Statistikave të Shqipërisë (INSTAT), në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë, hartoi për herë të parë një publikim të veçantë për treguesit kryesorë të ndërmarrjeve me pronësi të huaj dhe të përbashkëta që operojnë në Shqipëri.

Në vitin 2016, ndërmarrjet e huaja dhe të përbashkëta kanë punësuar 16 % të totalit të punësimit dhe kanë kontribuar me 22,7 % në totalin e xhiros vjetore.

Ndërmarrjet me pronësi 100% të huaj mbulojnë 71,4 % të totalit të ndërmarrjeve të huaja dhe të përbashkëta, ndërsa ndërmarrjet e përbashkëta me mbizotërim të huaj mbulojnë 14 % të tyre.

Në fund të vitit 2016, numri të ndërmarrjeve të huaja dhe të përbashkëta u ul me 5,1 %, krahasuar me vitin 2015. Për vitin 2016, peshën më të mëdha të ndërmarrjeve të huaja dhe të përbashkëta e japin Italia dhe Greqia me 56,5 % të ndërmarrjeve, 60,5 % të punësimit, 61,1 % të eksporteve dhe 47,5 % të importeve.


Ndërmarrjet e huaja dhe të përbashkëta

Në vitin 2016, ndërmarrjet me origjinë nga shtetet e Bashkimit Evropian zënë afërsisht 2,5 % të ndërmarrjeve aktive gjithsej në Shqipëri dhe 70 % të ndërmarrjeve të huaja dhe të përbashkëta. Ndërmarrjet me origjinë nga shtetet e Ballkanit Perëndimor përfaqësojnë 10,9 % të ndërmarrjeve të huaja dhe të përbashkëta. Ndërmarrjet me origjinë nga shtetet e tjera zënë 19,1 %.

Në ekonominë shqiptare, ndërmarrjet nga Shtetet EU janë mbizotëruese në shërbime të tjera (24,3 %), tregti (18,6 %) dhe industri (13,6 %), ndaj totalit të ndërmarrjeve të huaja dhe të përbashkëta.

Sipas madhësisë së ndërmarrjeve, bazuar në numrin e të punësuarve, në vitin 2016 ndërmarrjet e vogla nga vendet e BE-së mbulonin 77,1 % të të gjitha ndërmarrjeve të BE-së, ndërsa kompanitë e mëdha mbulonin 1,3 %. Kjo përqindje e bizneseve të vogla dhe të mëdha lidhet me veprimtarinë ekonomike ku ata veprojnë.


Fig.1 Struktura e ndërmarrjeve të huaja dhe të përbashkëta sipas shteteve, 2016



Treguesit kryesorë ekonomikë të ndërmarrjeve të huaja dhe të përbashkëta

Në vitin 2016, ndërmarrjet e huaja dhe të përbashkëta kanë punësuar 16 % të punësimit gjithsej, nga 17,7 % në vitin 2015. Shitjet neto të realizuara nga ndërmarrjet e huaja dhe të përbashkëta përbëjnë 22,7 % të shitjeve neto të ndërmarrjeve rezidente në vitin 2016, ndërsa gjatë vitit të kaluar ky tregues ishte 24,6 %. Përqindja e investimeve të realizuara nga ndërmarrjet e huaja dhe të përbashkëta është 46,9 % e investimeve gjithsej të vitit 2016, ndërsa në vitin 2015 ishte 42 %.

Fig.2 Përqindja e treguesve kryesorë në ndërmarrjet me pronësi të huaj dhe të përbashkët ndaj ndërmarrjeve shqiptare



Investimet e Huaja Direkte (IHD)

Investimet e Huaja Direkte janë një faktor kryesor i integritit ekonomik ndërkombëtar dhe globalizimit. Statistikat e besueshme të IHD-ve kanë qenë gjithmonë thelbësore për hartuesit e politikave që përballesh me sfidat e tërheqjes dhe shfrytëzimit të investimeve të huaja. Stoku i IHD është rritur me 14 %, në 2016 krahasuar me 2015. Në fund të vitit 2016, vendet e BE-së përbënin pjesën më të madhe të Stokut (59,3 %), të dominuara nga Greqia dhe Holanda respektivisht me 21,7 % dhe 12,6 %.

Tab.1 IHD, Stoku dhe Flow sipas vendeve (mil Euro)

IHD	Stoku			Flow		
	2014	2015	2016	2014	2015	2016
Gjithsej	4,565.9	4,981.7	5,677.3	869.2	890.4	942.5
EU-28	2,970.0	3,289.3	3,365.8	268.1	321.9	241.6
Austria	358.4	386.9	359.6	-11.9	23.1	23.1
Britania e Madhe	20.8	23.8	38.4	4.8	11.9	6.5
Gjermania	129.5	137.2	122.7	21.9	7.1	18.7
Greqia	1,179.6	1,204.8	1,232.6	118.5	41	10.3
Italia	523.7	547.5	604.4	37.8	11.2	45.7
Të tjera EU	758.0	989.1	1,008.1	97.0	227.6	137.3
Zvicra	79.4	120.6	550.1	73.7	146	432.6
Kanada	725.3	691.4	739.5	398.7	228	134.8
SH B A	88.4	94.5	80.8	35.3	3.5	10.2
Të tjera	702.8	785.9	941	93.4	191	123.4

Burimi: Banka e Shqipërisë

Tregtia e Mallrave sipas Ndërmarrjeve

Për vitin 2016, eksportet e ndërmarrjeve të huaja dhe të përbashkëta përbënin 48,2 % të eksporteve, nga 58,8 % në vitin 2015. Ndërsa, importet e këtyre ndërmarrjeve përbënin 29 % të importeve, nga 28,7 % në vitin 2015.

Tab. 2 Struktura eksport / import e ndërmarrjeve të huaja dhe të përbashkëta në totalin e ndërmarrjeve

Madhësia e ndërmarrjeve	Aktiviteti (NVE Rev.2)											
	2014				2015				2016			
	Totali	Industri	Tregti	Të tjera	Totali	Industri	Tregti	Të tjera	Totali	Industri	Tregti	Të tjera
Eksportet												
Totali	62,9	72,1	15,2	31,3	58,8	65,7	29,1	35,0	48,2	51,1	28,8	57,4
1-9	37,4	49,1	29,8	23,3	56,6	51,9	64,7	19,8	47,7	58,3	44,1	21,3
10-49	21,2	29,3	8,0	59,4	30,7	41,0	12,7	30,2	25,7	27,0	16,8	51,0
50-249	50,0	53,0	26,8	1,8	47,0	50,7	c	c	47,5	48,1	11,2	86,6
250+	84,5	88,6	2,4	43,5	75,9	81,1	c	c	58,2	59,3	-	84,3
Importet												
Totali	30,7	58,3	12,5	39,3	28,7	53,1	12,9	34,5	29,0	49,3	13,2	46,9
1-9	19,4	55,9	10,7	36,4	19,7	44,9	12,6	26,5	29,2	52,4	16,5	58,9
10-49	18,5	37,3	13,6	29,1	18,1	26,7	15,4	24,1	22,0	45,4	12,9	28,6
50-249	26,5	48,8	11,6	15,2	28,5	51,6	c	c	28,8	48,3	c	c
250+	62,2	70,2	15,9	67,6	53,2	69,2	c	c	43,1	52,5	c	c

Burimi: INSTAT

Për të lexuar publikimin e plotë mbi “Bizneset e Huaja në Shqipëri, 2014-2016” konsultohuni me linkun: <http://www.instat.gov.al/media/3649/bizneset-e-huaja-ne-shqiperi-2014-2016.pdf>

Metodologjia

INSTAT realizoi botimin e statistikave të ndërmarrjeve të huaja dhe të përbashkëta në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë. Ky botim përmban statistika nga sektorë të ndryshëm të dy institucioneve.

Statistikat përfshijnë gjithë ndërmarrjet që prodhojnë të mira e shërbime në Shqipëri, për të gjitha format. Popullsia është bazuar në ndërmarrjet të cilat sipas regjistrit statistikor janë aktive në dhjetor të vitit referues. Klasifikimi i ndërmarrjeve është bërë sipas Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike, NVE Rev.2. Të dhënat i përkasin periudhës vjetore kalendarike. Viti fiskal korrespondon me vitin kalendarik. Klasifikimi i ndërmarrjeve sipas madhësisë është bërë sipas numrit të të punësuarve (matur si të punësuar me kohë të plotë). Për më shumë informacion metodologjik referohuni link-eve:

Regjistri Statistikor

<http://www.instat.gov.al/al/temat/industria-tregtia-dhe-sh%C3%ABrbimet/regjistri-statistikor-i-nd%C3%ABmarrjeve/>

Statistikat Strukturore të Ndërmarrjeve

<http://www.instat.gov.al/al/temat/industria-tregtia-dhe-sh%C3%ABrbimet/statistikat-strukturore-t%C3%AB-nd%C3%ABmarrjeve-ekonomike/>

Banka e Shqipërisë

https://www.bankofalbania.org/web/Statistika_230_1.php

Statistikat e Tregtisë së Jashtme

<http://www.instat.gov.al/al/temat/tregtia-e-jashtme/tregtia-e-jashtme-e-mallrave/>

Përkufizimet kryesore

Ndërmarrja është njësi më e vogël e kombinimit të njësisë legale me njësinë e prodhimit të produkteve ose shërbimeve e cila ka pavarësi në vendim-marrje, sidomos për përdorimin e burimeve të saj materiale e monetare. Një ndërmarrje mund të ushtrojë një ose disa aktivitete ekonomike.

Shitjet neto përfshijnë shumat e faturuara për të gjithë aktivitetin e kryer nga njësi që vrojtohet për periudhën referuese dhe kjo korrespondon me vlerën e shitjes së mallrave dhe shërbimeve të tretëve, duke përjashtuar taksën mbi vlerën e shtuar. Ky variabël mund të gjendet në botimet e tjera me termat: shifra e afarizmit ose xhiro.

Numri i të punësuarve përfshin të gjithë personat që punojnë në ndërmarrje përfshirë pronarët, të punësuarit me pagesë si dhe pjesëtarët e familjes të papaguar.

Investimet gjatë periudhës referuese përfaqësojnë vlerën e mallrave afatgjata të blera prej ndërmarrjeve ose të krijuara për llogari të vet me qëllim përdorimi për një periudhë jo më të vogël se 1 vit në procesin e prodhimit, përfshirë tokën.